VENDIM
Nr. 98, datë 28.7.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "DENAS POWER" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "DENAS" ME FUQI TË INSTALUAR 14.5 MW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 germa "a" dhe 39 pika 3 dhe nenit 110 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1 germa "a"; 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa "a" të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21 datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.7.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Denas Power" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie nga Hec "Denas";

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Denas Power" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Leje nga institucionet e tjera (neni 9 pika 4.1.5) e cila është në proces, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit te licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "Denas Power" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit t ë energjisë elektrike nga Hec "Denas" me fuqi të instaluar 14.5 MW.
2. Kundërshtimet e palëve të interesuara ndaj këtij aplikimi mund të bëhen brenda 10 ditëve kalendarike nga botimi në gazetë i njoftimit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s mbi fillimin e procedurave të licencimit të këtij subjekti.
3. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti